



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

**VENDIM**

**Nr. 694, Datë 15.05.2020**

**“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në dosje””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.05.2020, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në Dosje”

**Baza Ligjore:** Nenet 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

**VËREN SE :**

1. E drejta për të patur akses në dosjen hetimore ka shumë rëndësi për ndërmarrjet nën hetim, sepse ju jep atyre mundësinë për të përgatitur pretendimet dhe mbrojtjen e tyre. E drejta e aksesit është e lidhur ngushtë me të drejtën për tu dëgjuar.
2. Ruajtja dhe mbrojtja e informacionit konfidencial të depozituar gjatë procedurave hetimore, mbron interesin legjitim të ndërmarrjeve nën hetim dhe në këtë mënyrë edhe konkurrencën e lirë dhe efektive, sepse ju kufizon konkurrentëve, aksesin në informacione sensitive të tilla si sekretet e buiznesit.
3. Udhëzimi trajton çështjet kryesore në lidhje me konfidencialitetin dhe aksesin në dosje, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të BE. Qëllimi i këtij udhëzimi është sqarimi i koncepteve të lidhura me konfidencialitetin dhe të drejtën e aksesit në dosje dhe procedurat që ndiqen sipas parashikimeve ligjore.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Udhëzuesit “Mbi konfidenciatitetin dhe aksesin në dosje”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**